

MENDIME RRETH ORGANIZIMIT TE SHERBIMIT SHENDETESOR NE KRAHINEN E HIMARES

N.Nesturi,S.Dhimolea,J.Gjoka,Th.Kumi

Niko Nesturi, Sotir Dhimolea

Historikisht në Palestinë e lashtë dhe në Himarën e vjetër, për shërimin e të sëmurëve që vuanin nga sëmundje të ndryshme si dhe për trajtimin e plagëve janë shfrytëzuar barrëra të ndryshme dhe mjetet natyrore të shëndetësisë (dielli, ajri, uji, balta). Njihen shumë kombinime infuzesh (Cajra) dhe dekokte që përgatiteshin nga kombinimi në raporte të përcaktuara të luleve, gjethëve, rrënjëve dhe lëvozhgave të bimëve të ndryshme, si dhe përdorimi i vajit të ullirit, dhjavit të cjaminë e të dashit, lëngu i rrushit, rakia etj..

Në këtë drejtim ndihmonte pozita gjeografike e trevës (bregdetare mesdhetare dhe ajo malore, duke u dhënë mundësia banorëve të përdornin në maksimum faktorët natyror të shëndetësisë (rrezet e diellit, ujin e detit, rërën e sidomos kumin dhe baltën) për kurimin e sëmundjeve të kyçeve. Po ashtu është njohur prej kohësh roli i ajrit të pastër i Qafës së Llogarasë në shërimin e sëmundjes së tuberkulozit.

Në Palasë-Dhërmi prej kohësh është përdorur edhe lymfa e drurit të arës, origjinën e së cilës nuk e kemi gjetur. Limf përftohej nga vendosja në shishen e vajit të një rrënje are, të pa shkëputur nga trangu, në muajin nëntor-dhjetor dhe marrja e lymfës në muajt-mars-prill, duke e përdorur atë kundër sëmundjeve reumatizmale, duke e pirë ose me fërkim. Metodë që mbështetet në fenomenin e osmozës.

Po ashtu në të gjitha fshatrat është përdorur nga të sëmurët kardiak çaji me bar blete. Ndërsa gjethet e borzilokut (vasiliko) janë përdorur kundër dhjamosjes si dhe në sëmundjen e “shkëndijës” së syrit (1-2 pika lëng nga shtrydhja e gjethëve të borzilokut). Dhërminjasit kanë përdorur dekoktin e përgatitur nga zierja e lëvores së drurit të goricës në dhimbjet e stomakut dhe kundër djersitjes së madhe të këmbëve dhe po ashtu çaj me kokrat e gjëmbaçi të gomarit për çbllokimin e urinës etj.

Plagët e shkaktuara nga shpata, shtiza dhe nga armët e zjarrit, familjarët përgatisnin pomada të shkëlqyera me përzierje të dhjavit të cjaminë me lule shtogu ose lule fshashëri.

Nga sëmundjet më të njohura prej të vjetërve kanë qënë :

- PUNTA (të ftohtit)
- PLEVITI (grumbullim uji në mushkëri).
- Tuberkulozi
- Canceri (carqino)
- Bllokimi i urinës etj.

Për trajtimin e tyre përdorehin :-Fërkimet me vaj, me krip, më vonë edhe me raki , përzierje.

-Me shumë efekt përdorehin - Ventuzat, madje edhe çarja e tyre me brisk për nxjerrjen e gjakut të “keq”.

-Përdorimi i kripës së nxehtë në sëmundjet e kyçeve (reumatizmit);-mbështjellja me lesh të palarë;

-Mbulimi i trupit me rërë të nxehtë etj.

Rreth vitit 1906, mjeku popullor Ilia Konomi (1852-1918) ka kryer një ndërhyrje “kirurgjikale “ shumë të komplikuar, me sukses, në një plagë në kokë, duke

bërë qepjen e cipave të trurit, tek ish adoleshenti I asaj kohe -A.Billa,me agrafe të improvizuara dhe duke e dezinfektuar me raki të fortë. Pra në trevën e Himarës ka patur mjeshtra edhe në fushën e mjekësisë.

Eshtë fakt i njohur se në vitet 20 të shekullit të kaluar në fshatrat e Himarës ka patur shumë mjekë të diplomuar. Kështu në Dhërmi kishte 5 doktorë, 11 me institut tregëtar dhe 9 mësues.Ndër ta përmëndim:dr.Milo.dr.Stefan Pano, dr.Zhupa, dr.Simonidhin. Në Vuno kishte 10 doktorë,31 me Institut tregëtar dhe 13 mësues,ku dallohej dr.Athanas Grillo. Në Himarë po ashtu kishte 11 doktorë, si dr.Rexho, dr.Kaçelano-Dëshmor i Atdheut etj.

Më vonë mbaruan studimet mjekët e shquar, at e bir Mihal e Prof. Petro Cani (Shef i kirurgjisë dhe Nderi i qarkut të Vlorës). Në vitin 1932 mbaroi studimet dr. Lluka Dhimolea, i cili u bë edhe Kryeinspektori Sanitar Shtetëtor i Shqipërisë,dr. Akile Milo, dr.Stefan Gjoni që tërë jetën e tij shërbeu në Krujë, ndërsa dr. Lluka Muço ishte shumë i nderuar dhe i respektuar në Berat.

Nga Vunoi duallën mjekët e shquar:

- dr. Pavlo Pavli, ish drejtor i drejtorisë së mjekimit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe profesor i mjekësisë ligjore në Fakultetin e Mjekësisë;
- dr. Perikli Sheti-kirurgu i talentuar, kandidati i parë i Shkencave Mjekësore, pedagog në Fakultetin e Mjekësisë;
- dr. Pavlo Milo njohës i mirë i organizimit shëndetësor etj.

Po ashtu me devocion punuan mjekët himariotë: dr. Kosta Kutulla, dr.Vangjelo Veizi (Grillo), mjekja e parë bregdetase-pediatre dhe pedagoge e njohur, dr.Evriadhi Goro-që drejtoi për 35 vjet shërbimin shëndetësor të zonës, së bashku me dr.Zaho Mëniko, dr.Spiro Buta , dr.Arqile Caci dhe dr. Filip Janila.

Vlen të theksojmë se në spitalin e Himarës (ngritur që në vitin 1936) dhe në të gjithë trevën,qysh në fillim të viteve tridhjetë të shekullit të kaluar, e deri më sot kanë dhënë kontributin e tyre të madh :dr. Mihal Cani nga Kudhësi, dr.Kalam Tako nga Përmeti, dr.Mihail Muka nga Durrësi, dr.Vangjelo Veizi (Grillo), dr.Evriadhi Goro, dr.Spiro Buta, të tre nga Himara ,dr. Arqile Caçi nga Palasa, dr.Filip Janila e dr.Aleksandra Gjokopulli nga Dhërmiu, Zaho e Vasil Mëniko etj.

Në të njëjtën kohë nuk duhet harruar puna plot pasion e ndihmës mjekut përmetar, Qani Isa Xhezo, dhëndër në Himarë, i cili jo vetëm që drejtoi me kompetencë të plotë disa vjet rresht spitalin e Himarës, por përfundoi me sukses edhe studimet e larta në Fakultetin e Mjekësisë, në një moshë madhore.

Kontribut të madh kanë dhënë edhe “mjekët praktik e popullor” pa diplomë ,siç i quante populli si dhe kuadrot e mesme mjekësore. Ndër ta përmëndim Ilia Konomi, Pavlo Vreto, infermierët e vjetër Kozma Nesturi (Hero i Punës dhe Nderi I Qarkut të Vlorës), Koço Kristofori, Mihal Lani, Ilia Gjergji dhe Ilia Kokuri nga Palasa, të cilët kanë dhënë një kontribut të madh në Spitalin Psikiatrik të Vlorës.Po ashtu Llambro Gjidede, ish-anëtar i shtabit të ushtrisë nacional çlirimtare në spitalin partizan në Ramicë, që më vonë nazistët e internuan në Kampin e Prishtinës.

Një ndihmesë të madhe kanë dhënë edhe farmacistët e vjetër e me shumë përvojë,të cilët ishin mjeshtra në përgatitjen e ilaçeve nga më të ndryshmet. Ndër ta kujtojmë zotërinjtë Irakli Rexho nga Himara, Vasil Kiço Jorgji, Koço Kiço Jorgji dhe Vasil Qirici Kocani nga Dhërmiu etj.

Ndërsa pas çlirimit kuadrot e mesme u shtuan duke shërbyer në vënde të ndryshme. Ndër ta përmëdim zotrinjtë e nderuar: Thoma Kokuri, Kiço Nesturi -veteran dhe invalid i LNCl, Sokrat Nesturi-depistuesi për tuberkulozin në krahinë;Theotoq Gjergji-stomatologu i parëi krahinës duke shërbyer 50 vjet rresht në Himarë, Thoma Gjokopulli, Foto Grillo, Pirro Kristofori, Shana Thana,Vangjeli e Katina në Himarë, Telua në Qeparo e deri tek më të rinjtë e të rejtat që vazhdojnë aktivitetin e tyre shumica e të cilëve aktualisht të emigruar ,sidomos në Greqi.

Vlen të theksojmë se në fund të shekullit të XX nga Himara ishin 118 mjekë, prej të cilëve 17 me tituj shkencor (profesor dhe doktor të. shkencave mjekësore) si dhe mbi 300 kuadro të mesme, duke shërbyer në të gjithë territorin e Shqipërisë. Shumë prej tyre u bënë specialistë shumë të zotë dhe drejtuan me shumë kompetencë.

Kështu krahas Prof. Petro Canit, dr.P.Pavli, dr.A.Milo, dr.P.Milo, dr.P.Sheti, që punuan në Tiranë, përmëdim : N.Nesturi në Mirditë, S.Kokuri në Tropojë, A.Gjini e Dh.Bendo në Pukë, S.Dhimolea në Gramsh, J.Guma në Sarandë, Jaso Lazari në Skrapar, A.Nika, K.Pavli, N.Gjokopulli, L.Dhimolea, F.Billa, T.Koçi, M.Billa, P.Loli, Ll.Gjidede, Ll.Bala , N. Dhima, L.Gjergji, T.Koçi , Artan Bala , Spiro Dhima etj., në Vlorë, A.Çaçi në Memaliaj, Kristo Gërdhuqi stomatolog në Lushnjë, Vasil A.Tato në Fier; Vasiliqi Milo(Lezo) në Sarandë; K.Duni, V.Kashta në fshatrat e Vlorës, L.Muço, P.Papai, Th.Neço, Petraq Th.Jani dhe A.Koka në Berat ; A.Konomi në Kuçovë, S. dhe E.Pavli, P.Vasili, O.Koço, V.Baka, L.Liza, Dh.Fotiadhi, G. Pano, F.Gjika, N. Milo (Rambi), L. Milo (Konomi), F.Gjika, Harilla Aleksii(Papajorgji) ish-i- internuar në kampet e përqëndrimit nga fashistët, A.Mato, Genci Pano në Tiranë etj.; Thanas Kulo, Ardit Duni, Edi Gjokopulli, Vilson Ruci, në Spitalin e Përgjithshëm Usharak, Th. Burbo në Laç, K.Cani e L. Konomi përkatësisht në Spitalin Infektiv dhe në Ortopedi në Tiranë e shume të tjerë.

Vetëm Himara në fillim te viteve 90-të kishte një spital me 40 shtretër, me patologji, pediatri e mikrokirurgji, kishte edhe 3 shtëpi lindjeje, 3 farmaci, 3 klinika dentare, 6 ambulanca këshillimore, Pik kunder tbc, Kabinet të Edukimit Shendetësor, 11 çerdhe për fëmijë. Në to shërbenin 60 punonjës të shëndetësisë, prej të cilëve 11 mjekë. Himara ishte ndër zonat me treguesit më të mirë shëndetësor.Po thuajse u eliminuan sëmundjet ngjitëse, tërë banorët u depistuan dhe u dispanserizuan, për 18 vjet rresht nuk pati asnjë vdekje të fëmijëve 0-1 vjeç, dhe jeta mesatare e njerëzve arriti në 79 vjeç(77 meshkujt dhe 83 femrat), u bënë studime për sëmundshmërinë e zonës duke nxjerrë dhe faktorët predispozues. Kështu studimet treguan për predominimin të sëmundjeve kardiovaskulare, sidomos i HA, diabetit mellitus etj. dhe si faktorë dilnin përdorimi i pijeve alkoolike, i duhanit, i brumërave dhe i kripës.

Periudha e gjatë dhe e vështirë që po kalon vëndi ynë, emigrimi i mbi 80% të popullsisë të trevës, reformat gjysmake të bëra deri tani, mos-kthimi i pronave pronarëve të ligjshëm etj., kanë bërë që aktualisht shërbimi shëndetësor në Himarë, të mos u përgjigjet kërkesave të kohës dhe sidomos ekonomisë së tregut dhe një zone me përparësi turistike.

Aktualisht në Qendër të Himarës ka një Qendër Shëndetësore me repartet e : reanimacionit, urgjencës, trajtimit ditor për të rritur e për fëmijët, me laborator klinik dhe me repart lindjeje. Por ajo ka mungesa të mëdha në mjedise, mjete e aparatura, madje deri para një viti nuk kishte as dhe një telefon për të kërkuar ndihmë urgjente, në një kohë që gjatë këtij sezoni turistik Himara pati mbi 30 mijë pushues.

Njëkohësisht ka edhe një ambulancë tip 2 në Dhërmi dhe 6 ambulanca tip-1 në fshatrat Kudhës, Pilur, Vuno, Ilias, Kondraq dhe Palasë. Pozitive është se ndërtesat e ambulancave të fshatrave janë ndërtesa të reja, gjatë dy viteve të fundit që Bashkia e Himarës po drejtohet nga z. Vasil Bollano. Gjithashtu Qendra Shëndetësore është e pajisur edhe me telefon, për të kërkuar ndihmë në çdo kohë (tel.nr.+ 355- 0393-2296) Po ashtu Farmacia e Qendrës në Himarë ka telefon me nr.+355-o69 2636344.

Në gjithë zonën shërbejnë vetëm 20 punonjës shëndetësie, pra 3 herë më pak, se deri në vitet nëntëdhjetë, e konkretisht janë 4 mjek, prej tyre 3 në këshillimoret e nënës e të fëmijës, 15 mami-infermiere, 1 laborante, krahas 2 sanitareve dhe 1 shofer.

Pozitiv është edhe fakti se edhe gjatë 13 viteve të fundit nuk ka patur asnjë vdekje në fëmijët e moshës 0-3 vjeç.

Vëmëndja kryesore e veprimtarisë së shërbimit shëndetësor të zonës është përqëndruar në keto drejtime :

- në edukimin shëndetësor të banorëve
- në imunizimin e popullatës
- në profilaksinë e hershme
- në mjekimin në kohë të sëmurëve

Treva ka ende probleme sidomos mbi gjëndjen higjieno-sanitare, e në veçanti rreth mbetjeve dhe plehrave urbane, ku ato janë të shpërndara në vend e pa vend, duke ndotur shumë mjedisin. Po ashtu ende nuk ka kanalizime për ujrat e zeza si dhe për ato të bardha, ku WC janë me gropa etj. Më problematike paraqiten zona e Potamit, e ish-kampit të punëtorëve të Dhërmiut dhe Qeparoi.

Mungon shërbimi veterinar,ku për tu theksuar është se vetëm gjatë 11 muajve të vitit 2005 në zonë ka patur 4 raste të reja me sëmundjen e Brucelozës. Negativisht ndikon edhe mungesa e therrtores, mos furnizimi i rregullt me ujë etj. Ndërsa në aspektin shëndetësor zona ka nevojë edhe për shërbimin radiologjik dhe për një laborator biokimik.

Mbështetur në këto probleme të mëdha shqetësuese dhe në resurset që ka treva jonë, mendojmë se **përspektiva dhe zhvillimi i shërbimit shëndetësor në të ardhmen të riorganizohet në këto tri drejtime :**

- 1 -Në qendër të Himarës dhe në të gjitha fshatrat e zonës.
- 2-Në pikat turistike(duke filluar nga Dhërlea e deri në Qeparo).
- 3-Organizimi i shërbimit shëndetësor të mbështetet në largësinë nga Vlora, qëndra mjekësore e specializuar rajonale.

Për sa sipër strategjia,ristrukturimi dhe planifikimi i shërbimit shëndetësor të bazohet :

a- Në shtrirjen gjeografike të zonës dhe në numrin e banorëve , për qendrën e Himarës, për secilin fshat dhe për secilën pikë turistike.

b- Në sëmundshmërinë e zonës dhe në veçoritë epidemiologjike të saj, sidomos në sëmundjet e zëmrës e të enëve të gjakut, të mëlçisë, të stomakut, ato onkologjike, në aksidentet e traumat etj.

c- Në urgjencën mjekësore, në mjetet e komunikimit, të telekomunikacionit, në aparaturat e reaminimit dhe në specializimin e personelit në këto fusha. Këto të shihen si për banorët e çdo fshati dhe për pushuesit vëndas e të huaj.

Ndërtimi organizativ i shërbimit shëndetësor

Grupi i punës mendon që në Qendër të Himarës, të ngrihet një Qendër Mjekësore polivalente, parandaluese, diagnostikuese dhe mjekuese. Ajo të përmbajë specialitetet :patologji, pediatri, obstetrikë-gjinekologji, mikrokirurgji, laborator klinik e biokimik, stomatologji, farmaci dhe njësia e urgjencës mjekësore. Personeli të përbëhet nga mjekë, mami-infermierë, laborant, stomatolog, farmacist. Në çdo fshat të ketë ambulancë-këshillimore. Në fshatrat e mëdha të ketë mjek e infermierë, ndërsa në fshatrat e vogla të ketë mami-infermiere, duke shkuar mjeku në ditë të caktuara .

Mjekësia e turizmit- si bazë kryesore të jetë shërbimi i urgjencës së përgjithshme, për banorët dhe gjatë sezonit turistik edhe për pushuesit.

- Të ketë Njësi të Ndhmës së Shpejtë për urgjencat në det
- Të ketë mjetet e komunikacionit si autombulanca, motoskafe të pajisura me valixhe- çanta të urgjencës, si dhe mjete të telekomunikacionit.
- Burimet financiare mendojmë të jenë nga -shteti, Ministria e Shëndetësisë, Bashkia e Himarës, biznesmenët vëndas, komuniteti dhe programet e përbashkëta me organizatat e institucione të ndryshme ndërkombëtare.

Aktiviteti i shërbimit mjekësor dhe lidhjet e tij me turizmin të fokusohen, sidomos në :

- Vlerat mjekësore të turizmit klimaterik, bregdeti, fshati dhe klima malore
- Vlerat mjekuese të zonës bregdetare -helioterapia, hidroterapia, banjot e rërës, masazhet, kalitja fizike.

Kështu këto metoda do të ndihmojnë të hidhin bazat e turizmit historik duke rritur përfitimet mjekësore së bashku me ekoturizmin dhe bioturizmin.